



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-06/IA026

Vendosi: Kryetarja e Dhomave të Specializuara
Gjykatëse Ekaterina Trendafilova

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 3 shkurt 2023

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*

Vendim për Caktimin e Panelit të Gjykatës së Apelit

Gjykatësve të Panelit të Gjykatës së Apelit:

Gjykatëse Mishelë Pikar

Gjykatës Emilio Gati

Gjykatës Kai Ambos

Zyrës së Pjesëmarrjes së Viktimave:

Shefit të Zyrës së Pjesëmarrjes së Viktimave

Mbrojtësit të Viktimave:

Sajmon Loz

Mbrojtëses së Parashtruesve të Kërkesave të Refuzuara:

Jelena Cakiq

KRYETARJA e Dhomave të Specializuara (“Kryetarja”), duke vepruar në bazë të neneve 33(1)(c) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, rregullave 113(6) dhe 169 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës dhe rregullave 3 dhe 4 të Rregullores për Caktimin e Gjykatësve të Dhomave të Specializuara nga Regjistri i Gjykatësve Ndërkombëtarë (“Rregullorja për Caktimin e Gjykatësve”), me anë të këtij vendimi cakton një Panel të Gjykatës së Apelit për të vendosur në lidhje me Kërkesën për Zgjatjen e Afatit për Dorëzimin e Apelit kundër Vendimit të Katërt mbi Pjesëmarrjen e Viktimave (“Kërkesa”).¹

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 12 dhjetor 2022, Gjykatësi i Procedurës Paraprake nxori Vendimin e Katërt në lidhje me Pjesëmarrjen e Viktimave (“Vendimi i Kundërshtuar”), ku, ndër të tjera, refuzoi kërkesat e disa parashtruesve për të marrë pjesë si viktimë në proceset aktuale.²
2. Më 2 shkurt 2023, Mbrojtësja e parashtruesve të kërkesave të cilëve u është refuzuar pjesëmarrja, dorëzoi Kërkesën.

II. KLASIFIKIMI

3. Kërkesa është klasifikuar si rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte* dhe për rrjedhojë edhe ky vendim do të ketë të njëjtin klasifikim në përputhje me rregullën 82(4) të Rregullores derisa të riklasifikohet më vonë në përputhje me rregullën 3(4) të Rregullores për Caktimin e Gjykatësve.

¹ IA026/F00001, Kërkesë për Zgjatjen e Afatit për Dorëzimin e Apelit kundër Vendimit të Katërt mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, 2 shkurt 2023 (rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*).

² F01152, Vendimi i Katërt mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, 12 dhjetor 2022 (rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*), paragrafi 73(b). Një version i redaktuar publik i Vendimit të Kundërshtuar u dorëzua më të njëjtën ditë. Shih F01152/RED.

III. CAKTIMI

4. Pas shqyrtimit të kriterëve të përcaktuara në rregullën 4 të Rregullores për Caktimin e Gjykatësve, duke përfshirë përvojën dhe kompetencën përkatëse, si edhe disponueshmërisë në këtë moment,

KRYETARJA ME KËTË VENDIM CAKTON:

Gjykatëse Mishelë Pïkar

Gjykatës Emilio Gati

Gjykatës Kai Ambos

në Panelin e Gjykatës së Apelit për të vendosur në lidhje me Kërkesën.

/nënshkrimi/

Gjykatëse Ekaterina Trendafilova,
Kryetare e Dhomave të Specializuara

E premte, 3 shkurt 2023
Hagë,
Holandë